



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 72/2021 (JR)  
Nr. 72/2 regj.

Tiranë, më 3.12.2023

**SHPALLJE  
E**

**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË GJYQËSORE PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrës në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën e enjte, më datë 18.01.2024, ora 10:00, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër regjistri (JR) 72/2021, datë 23.11.2021, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 442, datë 14.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjykses**  
**Relatore e Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtar**

**Ina Rama**  
**Natasha Mulaj**  
**Albana Shtylla**  
**Rezarta Schuetz**  
**Sokol Çomo**

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjyqimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim publikohet edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Me njoftim individual njoftohet subjekti i rivlerësimit, në të dhënat elektronike të kontaktit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Institucioni i Komisionerëve Publikë në të dhënat elektronike të tij.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**

**INA RAMA**

